



KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE JOPUBLIKE PËR LIDHJEN E KONTRATËS ME FONDIN

1. Kriteret që duhet të plotësojnë institucionet shëndetësore jopublike për lidhjen e kontratës me Fondin janë:

1.1 Kriteret të përgjithshme:

- a) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i licencuar pranë QKB-së për shërbimin shëndetësor që do të kontraktohet;
- b) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i regjistruar pranë organeve tatimore në rajonin ku kryen aktivitetin;
- c) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë me llogari bankare në një bankë të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë;
- d) Institucioni shëndetësor jopublik duhet të jetë i pajisur me pajisjet e nevojshme kompjuterike dhe krijimin e një database/programi, i cili të instalohet dhe të jetë i aksesueshëm online nga Fondi;
- e) Mjekët specialistë, të cilët do të kryejnë procedurat e paketave shëndetësore të miratuara dhe të kontraktuara nga Fondi, nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike;
- f) Mjekët specialistë, të cilët do të kryejnë procedurat e paketave shëndetësore të miratuara dhe të kontraktuara nga Fondi, nuk kanë thyer marrëveshjen me Ministrinë e Shëndetësisë, në lidhje me përfitimin e specializimeve pasuniversitare;
- g) Institucioni shëndetësor jopublik nuk duhet të jetë në procedurë falimentimi dhe likuidimi.

1.2 Kriteret të veçanta:

Kriteret e veçanta janë specifike sipas shërbimit që kontraktohet.

1.2.1 Për shërbimin e dializës:

- a) Institucioni shëndetësor jopublik, duhet të ketë laborator kliniko-biokimik e mikrobiologjik, pranë çdo qendre të ofrimit të paketës së hemodializës;
- b) Shërbimi i dializës do të kryhet pranë qendrave që kanë në dispozicion qendër spitalore, e cila ka minimumi shërbim urgjence, sëmundje interne, kardiologji, nefrologji dhe shërbim intensiv me minimumi 3 shtretër.
- c) Pajisja e laboratorëve mjekësorë me licensën e mjekut dhe drejtuesit teknik;
- d) Të ketë minimumi dy mjekë të punësuar me kontratë me kohë të plotë, ku minimumi të ketë një mjek specialist nefrolog;

- e) Të ketë shërbimin e urgjencës 24 orë për paketën shëndetësore të dializës;
- f) Të ketë minimalisht 5 (pesë) aparate të dializës me shtretër përkatës;
- g) Të ketë 3 (tre) shtretër të veçantë për pacientët me hepatit të tipeve të ndryshme;
- h) Të ketë një aparat të lëvizshëm të dializës, i cili të bëjë dhe hemodiafiltracion dhe biofiltracion;
- i) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

1.2.2 Për shërbimin e kardiologjisë:

- a) Të ketë minimumi katër mjek të fushës së kardiologjisë të punësuar me kohë të plotë në institucion. Duhet të ketë minimumi dy mjekë anestezistë reanimator me kohë të plotë;
- b) Të ketë minimumi gjashtë shtretër në shërbimin e kardiologjisë dhe një sallë angiografie, të ketë minimumi katër shtretër në reanimacionin e shërbimit të kardiologjisë invazive. Të ketë të gjitha asetet/pajisjet mjekësore të shërbimit të kardiologjisë invazive;
- c) Të ketë një shtrat (vend të lirë) të dedikuar për referimet urgjente që vijnë nga Fondi;
- d) Të ketë shërbim urgjence 24 orë të mbuluar me mjekë;
- e) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

1.2.3 Për shërbimin e kardiokirurgjisë:

- a) Të ketë minimumi dy mjek të fushës së kardiokirurgjisë të punësuar me kohë të plotë në institucion. Duhet të ketë minimumi dy mjekë anestezistë reanimator me kohë të plotë;
- b) Të ketë minimumi pesë shtretër në reanimacionin e kardiokirurgjisë, pesë shtretër në shërbimin e kardiokirurgjisë, si dhe dy salla operatore, që i përkasin operacioneve vaskulare. Të ketë të gjitha asetet/pajisjet mjekësore të sallës operatore kardiokirurgjike përfshirë dhe Balonë Intraaortike(IABP);
- c) Të ketë një shtrat (vend të lirë) të dedikuar për referimet urgjente që vijnë nga Fondi;
- d) Të ketë shërbim urgjence 24 orë të mbuluar me mjekë;
- e) Të ketë në pronësi një autoambulancë në gjendje gadishmërie, me kohë të plotë.

1.2.4 Për shërbimin e transplantit të veshkës:

Të plotësojë kriteret e parashikuara në VKM-në nr. 206, datë 13.03.2013, lidhur me :

- a) Kriteret e veçanta të ndërtimit;
- b) Kriteret për personelin mjekësor në qendrën e transplantimit;
- c) Kriteret për ruajtjen e dokumentacionit të aktivitetit të qendrës;
- d) Pajisjet e nevojshme për sallën e operacionit, reanimacionin dhe dhomat e pacientëve.

1.2.5 Për shërbimin e implantit koklear:

- a) Të ketë të kontraktuar të paktën 1 (një) mjek specialist otorinolaringolog të specializuar për vendosjen e implantit koklear;
- b) Të ketë të paktën 1 (një) bllok operator-reanimacioni, sipas standardeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi me datë 31.03.2017.